



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL

Nr. 9, datë 10.09.2025

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak

Orari i fillimit të mbledhjes : 13:22

Data e mbajtjes së mbledhjes : 10.09.2025

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Zëvendëskryetari i Bashkisë z.Elio Jani si dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Denisa Luarasi: Përshëndetje të gjithëve!

Të nderuar këshilltarë ! I nderuar zëvendëskryetar! Të nderuar të pranishëm!

Uroj të keni kaluar pushime të mbara. Ju uroj mësuesve dhe nxënësve tanë të dashur shumë suksese në këtë vit të ri shkollor. E deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës Këshillit Bashkiak. Me materialet jeni bërë të njohur nëpërmjet email-it nga sekretarja jonë e këshillit. Ftoj sekretaren të bëjë prezencën.

Dorina Milja: Përshëndetje ! Fillojmë prezencën...

Ardian Mukaderi tek.... Florian Tahiri...

Erdhi dhe Luani 36. Është prezent edhe kandidatja e re për të marrë mandatin Mirela Shala.

Kuorumi është i pranishëm, 36 këshilltarë në sallë.

(V.O. Hyn me vonesë në sallë këshilltari Jonuz Myshketa . Gjithsej në mbledhje 37 këshilltarë).

Denisa Luarasi: : Shumë faleminderit.

Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me mbledhjen. Sot kemi 8 pika në rend të ditës, po fillojmë me leximin e tyre.

Pika 1.	PËR MIRATIMIN E MANDATIT TË ANËTARES SË KËSHILLIT BASHKIAK ZNJ. MIRELA RASIM SHALA
Pika 2.	PËR MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL 2025-2028, TË BASHKISË Durrës
Pika 3.	PËR MIRATIMIN E PLANIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR 2026-2028 NË BASHKINË Durrës
Pika 4.	PËR MIRATIMIN E PROJEKTDOKUMENTIT TË PARË TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM 2026-2028 TË BASHKISË Durrës
Pika 5.	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË Durrës, PËR MUAJIN GUSHT 2025
Pika 6.	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 6.200.000 (GJASHTË MILION E DYQIND MIJË) LEKË PËR FURNIZIMIN ME ORENDI E PAJISJE TË SHKOLLËS SË MESME TË PËRGJITHSHME MANËZ, NJËSIA ADMINISTRATIVE MANËZ, SIPAS PROJEKTIT “FV ORENDI E PAJISJE GJIMNAZI MANËZ”
Pika 7.	PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK SI SUBJEKT I KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA MIDIS NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR RRITJEN E KAPACITETEVE TË QEVERISJES VENDORE, AKADEMIJA E TRAJNIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (TALGA)
Pika 8 dhe e fundit	PËR MIRATIMIN E NJË SHTESE NË PIKËN NR. 2 TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 66, DATË 25.06.2024 “PËR PËRCAKTIMIN E ZONAVE TË ADMINISTRIMIT TË PARKIMIT DHE TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË PARKIMIT ME PAGESË NË RRUGË DHE SHESHE NË TERRITORIN E BASHKISË Durrës”

Keni ndonjë koment?

Jeni dakort me rendin e ditës?

Kalojmë votim, kush është pro?

Kundër?....

Atëherë me 36 vota pro miratohet pa ndryshime dhe rendi i ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 1**, Komisionit të Mandateve me kryetare zonjën Ana Dhamo që të paraqesë raportin e verifikimit të mandatit.

Ana Dhamo: Përshëndetje të gjithëve.

Komisioni i Mandateve u mbledh dhe pasi verifikoi dokumentacionin e ardhur nga Sekretaria e Këshillit vendosi që ta kalojë sot për votim në Këshillin Bashkiak, vërtetimin e vlefshmërisë së mandatit të zonjës Mirela Rasim Shala. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Dhamo.

Ju ftoj që ta votojmë raportin e komisionit.

Kush është pro?

Kundër ? Abstenim?

Me 36 vota pro miratohet.

Ftoj zonjën Mirela Shala që të ngrihet në këmbë. Unë do ju lexoj formulën e betimit dhe ju pas leximit do të thoni “betohem”. Ngrihem dhe unë për respekt formulës.

“Betohem në nderin tim, se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të këshillit bashkiak dhe do t'i bindem kushtetutës dhe ligjeve. Betohem, se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të bashkisë Durrës dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre”.

Mirela Shala : Betohem.

Denisa Luarasi: Suksese.

Përpara e keni formulën e betimit që jua ka lënë sekretarja dhe duhet ta firmosni.

Ju uroj mirëseardhje në Këshillin tonë bashkiak dhe ju uroj suksese.

Këshillit Bashkiak Durrës i plotësohet vakanca dhe ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 2** Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë përshëndetje të gjithëve.

Komisioni ynë me shumicë votash e miratoi pikën 2 dhe ftojmë këshillin sot që të japi votën pro. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

E merr fjalën Komisioni i Barazisë Gjinore Mirëqenies Sociale dhe Mosdiskriminim zonja Eda Harizi. Mund ta hapni mikrofonin?

Edlira Shemsi: Dëgjohet.

Denisa Luarasi: Po

Edlira Shemsi: Komisioni në shumicën e tij vendosi që materialet t’ja paraqesi Këshillit Bashkiak për vlerësim dhe miratim.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Shemsi, Harizi.

Atëherë komente, pyetje ka?

Mund ta thërrasësh pak?

Dritan Burgjia: Përshëndetje të gjithëve.

Mirë se rikthehemi pas pushimeve. Nja dy komente në lidhje me planin social.

Me çfarë kemi vënë re te plani social, pa dashur të themi që do ta votojmë kundër, do ta votojmë pro për aq sa i shërben qytetarëve, por kemi has problematikat që janë kryer në procedurën e hartimit. Planin social vendor 2025-2028 në këndvështrimin tonë, ka patur një procedurë konsultimi publik online të paqartë për një periudhë shumë të shkurtër, 25 korrik - 25 gusht. Kjo kohë përkon me pushimet dhe njerëzit janë të pavëmendshëm te kjo gjë. Nuk ka evidenca të qarta për pjesëmarrjen siç shihet edhe në proces-verbalin e përmbledhjeve të rekomandimeve që është dërguar. Kjo duket qartë edhe nga pjesëmarrja e dobët e shoqërisë civile e cila në Durrës ka goxha aktivitete për romët, për të moshuarit, për shoqëria civile është goxha aktive në qytetin e Durrësit. Një plan vendor jo transparent pa specifikuar shërbimet për kategoritë në nevojë, sidomos për të moshuarit pa mbështetje, personat me aftësi të kufizuar, pa u mbështetur në sugjerimet e komunitetit nuk i shërben qytetit, krijon vend për abuzime duke i çuar ato jo drejtë, duke i çuar fondet jo drejtë nevojave reale të qytetarëve, por drejt abuzimeve. Planin vendor duhej diskutuar në prezencën e përfaqësuesve të komunitetit, ekspertëve që e kanë hartuar në mënyrë që të ballafaqohen mundësitë e bashkisë me nevojat e këtij komuniteti. Domethënë kemi një plan në letër të padiskutuar dhe të njëanshëm. Nga ana tjetër vetë analiza e kryer evidenton përkeqësimin e treguesve të papunësisë të rinjve, rritje të varfërisë, përkeqësimin e treguesve në përfshirjen e fëmijëve në arsim, përfshirjen e personave me aftësi të kufizuar në jetën aktive për shkak të moszbatimit të ligjit për punësimin e tyre. Nuk ka një analizë ku ka dështuar plani i vjetër dhe ku është bazuar hartimi i planit të ri. Siç thashë në fillim, ne për aq sa i shërben qytetarëve, ne do ta votojmë pro gjithsesi.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Burgjia.

Po zonja Harizi.

Edlira Shemsi: Jo, shparë mendova që bëhej fjalë për miratimin e ndihmës ekonomike dhe nuk e kuptova që ishte për planin social. Në lidhje me planin social në komision sigurisht me shumicë ne e paraqitëm në këshill dhe këshilli do ta vlerësojë miratimin apo jo, por në komision ne nuk patëm përfaqësues të bashkisë nga Drejtoria e Asistencës Sociale dhe Zyra Juridike e bashkisë që duhet të na jepnin përgjigje për disa pyetje që ne bëmë.

E para, është theksuar në raportin e paraqitur që janë të dhëna vetëm për vitin janar-maj 2024, pasi thotë, për shkak të mos bashkëpunimit dhe të marrjes së qartë të të dhënave ndërmjet faktorëve shërbim social vendor, koordinatori vendor, gjykata, prokurori, polici, ne nuk kemi të dhënat e plota të vitit, që tregon që ka një moskoordinim të qartë të punës që është një punë që e ka bërë detyrë bashkia dhe të gjitha institucionet e tjera.

Tjetër, sipas vetë asaj çfarë është pranuar në këtë raport, sipas auditimit të bërë në fakt jo thjesht nga bashkia, por auditimi që i është bërë bashkisë në Durrës është vërtetuar që kemi një pamjaftueshmëri të mbulimit të gjithë territorit të bashkisë Durrës, me ndihmën, me strukturën që duhet të jepet për familjet dhe individët në nevojë, ndihmë ekonomike apo nevoja të tjera, ato që

janë pre e dhunës apo problematika të tjera që lidhen me mbështetjen sociale dhe duke qenë që gati gjysma e territorit nuk është zonë urbane, pasi pranohet nga auditimi i bërë që ka lënë detyrë bashkisë që është mbuluar zona urbane, por zona rurale që është gati gjysma e bashkisë së Durrës është pambuluar, tregon se sa e pamjaftueshme ka qenë asistenca, evidentimi i nevojave dhe dhënia e ndihmës për këto nevoja.

Tjetër, thuhet që një pjesë e këtyre fondeve që janë dhënë për OJF kryesisht në fushën e emergjencave sociale, prapë janë evidentuar boshlliqe në dhënien në gjithë territorin, por edhe në marrëdhëniet që ato kanë pasur me faktorë të tjerë duke përfshirë këtu bashkinë. Dhe nga ana tjetër nuk dihet qartësisht kush janë ata që bëjnë auditimin e fondeve të marra nga OJF-të. Këtu në raport në fakt përmenden vetëm dy OJF. Në fakt janë disa që kooperojnë për aq sa ne kemi dijeni në bashkinë e Durrësit. Këtu përmendet qendra “Fuqizojmë Komunitetin” dhe qendra “Për shërbimet emergjente dhe mbrojtjen fuqizimin e fëmijëve dhe familje me nevojë”. Janë disa për aq sa ne kemi dijeni, madje njëra ishte dje prezent në mbledhje, por nuk pati përfaqësues të bashkisë që t’u jepnin përgjigje dhe thuhet që këto kanë marrë fonde nga të tretë, nga ambasada zvicerane, suedeze apo dhe fondacione të tjera deri para pak kohësh dhe nga USAID-i dhe nga bashkia, por nuk dihet kush e bën auditimin e këtyre fondeve, si janë dhënë këto realisht, pasi ka raporte të paraqitura me numra, por pa emra faktikë, pa adresa. Ku, si, qysh, tek, janë adresuar këto fonde dhe realisht sa i kanë shërbyer këtyre personave dhe familjeve në nevojë? Pa dashur të aludoj dhe të them që të tregohem mosbesuese që fondet kanë shkuar aty ku duhet, por për aq kohë sa nuk ka raport analitik të qartë, sigurisht që të lindë pyetja që ku kanë shkuar vërtetë.

Tjetër gjë, në lidhje me planin për 2024-2025-ën në vazhdim, thuhet në vitin 2025 ne do vazhdojmë të bëjmë një analizë çfarë kemi bërë. Ne do vazhdojmë të hartojmë module të reja dhe të ndjekim si po vazhdojnë qendrat që janë ngritur ndërkohë që mungojnë shumë qendra. E pranonte vetë auditimi, them jo thjesht bashkia apo auditimi i bërë për bashkinë, që mungojnë qendra në një territor të caktuar, nuk janë prezent qendrat komunitare të bashkisë apo mungojnë thuhet specialistë të fushës në vetë qendrat administrative që varen nga bashkia, apo mungojnë thotë specialistë të fushës që duhet të merren me invalidët apo me personat që kanë varësi nga droga apo me të moshuarit me problematika. E pranon bashkia vetë dhe e pranon auditimi i bërë që këta specialistë të fushës të mungojnë dhe si rrjedhim kjo kategori personash nuk e ka marrë ndihmën dhe suportin e duhur për problematikën që ato paraqesin.

Tjetër gjë, thuhet në vitin domethënë në 2025-ën do bëhet organizimi i fushatave ndërgjegjësuese dhe të hartohen modulet e reja. Deri këtu asnjë gjë për të dhënat reale sa do jenë fondet e disponueshme financiare dhe ku do shkojnë realisht? Jemi akoma në fushën e ndërgjegjësimit 2025-ën. Në 2026-ën thuhet prapë, do ngrejmë shërbimet dhe do bëjmë konsultat duke përfshirë komunitetin dhe do ndërtojmë databazën për të gjithë këtë. Po deri tani kush është databaza reale nuk thuhet, nuk kemi një databazë reale është pranuar për shkak të mosfunksionimit të gjithë këtyre faktorëve siç e thashë më parë bashki, OJF, polici, prokurori dhe të gjithë me radhë nuk ka një databazë reale për të gjithë problematikën e personave dhe familjeve që kërkojnë ndihmë dhe suport ekonomik. Nuk ka të dhëna sa do jetë fondi si, qysh, tek, në 2027-n, 2028-n në vazhdim, atëherë thotë do fillojmë zgjerimin e shërbimeve sociale, në 2028-ën, do fillojë zgjerimi i shërbimeve. Deri 2028-ën është pranuar që nuk ka specialistë të fushës që mungojnë qendrat në një zonë jo të vogël territoriale të bashkisë, sepse janë të përqëndruara vetëm në zonat urbane dhe në 2028-ën thotë do fillojmë të zgjerojmë shërbimet sociale dhe të besojmë pastaj impaktin e tyre

në komunitet dhe bashkëpunimin me faktorët e tjerë. Deri këtu është shumë i paqartë çdo bëhet realisht se bie që dy vite të bëhet vetëm ndërgjegjësim vetëm propagandë janë.

Denisa Luarasi : Znj. Shensi të ftojme dikë nga administrata të na sqarojë.

Edlira Shensi: I bie pasataj 2025, 2026 deri në 2027-n, ndoshta mund të mos jetë këtu kështu siç është e shkruar këtu. Por unë nuk e pata përgjigjen nga përfaqësuesit e bashkisë pasi munguan i pritëm gati një orë mbasi mbaroi mbledhja nuk erdhën dhe unë detyrohem t'i bëj këtë pyetje këtu në komision në këshill pasi në komision nuk e mora këtë përgjigje.

Dhe më fal dhe një gjë në lidhje me strukturat emergjente të dhënies së emergjencës për persona që kërkojnë ndihmë që janë në hall e në nevojë ekonomike. Po më fal ku ka hall më të madh se pensionistët, invalidët që kanë dy vjet që paguajnë fonde ato bonuset, që nuk i marrin nga bashkia, i paguajnë nga pensionet e veta. Ku ka hall më të madh se kaq, ku ka emergjencë më të madhe se kaq sociale që bashkia as nuk i fut në shtëpia, që gati 996 veta kanë marrë çelësat dhe nuk futen dhe nuk marrin, nuk marrin bonuset. Nuk është emergjencë kjo. Emergjencë sociale, detyrim ligjor dhe emergjencë sociale.

Denisa Luarasi: Mos të dalim nga pika.

T'i përmbahemi pikës dy.

Eda Shensi : Kjo është brenda kësaj pike. Emergjencë është kjo. Unë e konsideroj emergjencë. Ndoshta bashkia s'e konsideron emergjencë, por unë dhe ata njerëz që më janë drejtuar e konsiderojnë emergjencë. Dhe kanë arritur deri aty sa kanë dalë në media me thirrjen, me thirrjen i lutemi Zotit të na fusi brenda gjëkundi.

Denisa Luarasi: Faleminderit.

.....shumë zhurmë.....

Edlira Harizi: Jo unë jam shumë e qetë që juve,..... dhe në shërbim të komunitetin. Po nuk kanë qetësi qytetarët drejtohen tek ne, s'janë të qetë Unë prandaj jam këtu. Unë prandaj jam këtu.

Dritan Burgija: Shiko, e kemi, e kemi marrë vesh sot në kohë reale që po ndani çelësat. Ky është një lajm i mirë. Në maj e kam bërë unë pyetje këtu se kur do ndahen çelat.

Denisa Luarasi: Atëherë zoti nënkryetar do ta merrni fjalën?

Munir Konesha : Nga drejtuesit e këshillit që të përcaktohet një kohë për çdo çështje, ju lutem shumë, të përcaktohet një kohë diskutimi për çdo pikë dhe për çdo grup. Kështu është krejt normale që çdo njeri mund të marr fjalën këtu dhe gjysëm ore mund ta mbaj unë fjalën.

Denisa Luarasi: Dakord?

Ada të lutem afrohu tek mikrofoni dhe ta dëgjojmë. Ta dëgjojmë. Ju lutem.

Eralda Mukaj: Përshëndetje.

.....shumë zhurmë.....

Denisa Luarasi: Të lutem të dëgjojmë përfaqësuesen e administratës.

Pak qetësi ju lutem. Të lutem, të lutem pak qetësi.

Ju lutem pak qetësi andej mbrapa ose dilni përjashta.

Ju lutem pak qetësi tek të ftuarit, qetësi ose dilni përjashta.

Eralda Mukaj: Atëherë unë jam Eralda Mukaj. Jam përfaqësuese e Drejtorisë së Shërbimit Social. Përsa i përket takimit të djeshëm, duke qenë që drejtoresha jonë është me leje të zakonshme, ka ndodhur një keqkuptim. Kemi ardhur 20 minuta me vonesë, jo një orë. Është shumë e vërtetë. Megjithatë nuk ishte faji jonë, ishte thjesht mungesë komunikimi në kohën e duhur.

Ndërsa për pjesën tjetër përsa i përket konsultimeve që janë bërë të këtyre, mbledhjes dhe grumbullimit të të dhënave për të vazhduar planin social, jo për ta rindërtuar nga fillimi. Janë bërë disa takime rrjesht pothuajse disa muaj, ndoshta një vit ose gjashtë muaj, kanë qenë çdo tre javë, dhe këta konsulentët tanë kanë dërguar email-e të vazhdueshme në të gjithë organizatat dhe shumë pak prej tyre janë përgjigjur. Jo vetëm organizatat joqeveritare, por edhe institucionet e tjera që kanë marrë pjesë të ky hartim i planit social. Kështu që nuk është që kanë qenë të përjashtuar. Asnjë nuk ka qenë i përjashtuar nga kjo. Përsa i përket fondeve dhe më fal urdhëro.....

.....Dritan Burgija flet pa mikrofon.....

Denisa Luarasi: Të lutem Burgia të lutem të përfundoj. Të lutem të përfundoj zonja, Mukaj.

Jo jo të lutem se u bë si pazar këtu. Tani të lutem pak më e koncentruar e shpejtë, pasi do e kalojmë në votim.

Eralda Mukaj : Përsa i përket kontroll asaj auditimit të fondeve që kanë ardhur janë të gjitha të bëra nga KLSH-ja. Dosja ekziston e planit social. Gjithë projektet ça janë, që janë marrë fonde dhe janë dhënë fonde. Për pjesën e dhënies së fondeve aq fonde sa janë dhënë nga drejtoria është bërë e gjitha me auditim. Ne nuk kemi lidhje si të thuash në mënyrë të drejtpërdrejtë fare, sepse është bërë te zyra e prokurimeve që është brenda institucionit tonë.

Për pjesën e punonjësve të përfshirë në të gjitha njësitë administrative, janë në të gjitha njësitë administrative përveç Ishmit edhe Manzës më duket, që të gjitha mbulohen nga administratori social. Punonjësit social përveç këtyre që janë NJVNRT që i themi ne, në të gjitha njësitë, ka edhe punonjës social që merren enkas me pritjen e popullit për të dëgjuar nga afër dhe për të mbledhur informacionet edhe për t'i drejtuar njerëzit atje ku kanë nevojë më shumë.

Kështu që ne vetëm na ngelet që të vazhdojmë të punojmë pak më fort për të mbajtur fort këto shërbime që kemi ngritur tashmë edhe do na ndihmonin, plani social domethënë do ishte ai udhëzuesi ynë për vazhdimin e punës tonë.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit zonja Mukaj.

Kalojmë votim. Kush është pro pikës 2 të rendit ditës?

Kundër? Abstenim?...

Me 37 vota pro miratohet pa ndryshime pika 2 e rendit të ditës.

- Kalojmë tek pika tre. I jepet fjala për projektvendimin e pikës 3 Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Po kryetare.

Edhe për pikën 3, Komisioni ynë me shumicë votash votoi pro dhe ftojme të bindur që Këshilli të japi miratimin sot.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

E merr fjalën Komisioni i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit, zonja Blerina Reçi.

Blerina, të lutem përsërite.

Blerina Reçi: Po. Përsëritje të gjithëve.

Edhe komisioni ynë i arsimit, kulturës, rinisë, sporteve dhe komuniteteve fetare e aprovoi unanimisht pikën 3. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit zonja Reçi.

Komente, pyetje keni?

Po zonja Shala.

Mirela Shala : Nuk e di a dëgjohem? Ok. Unë jam sot e re. Gjithsesi nuk është hera e parë që vij në Këshill Bashkiak. Kam qenë dikur.

Dritan Burgjia : Kështu që nuk e di se çfarë kemi ndonjë gjë këtu.

Mirela Shala : Kemi një problem.

Unë e mbylla, por e ka problemin mikrofoni.

Denisa Luarasi : Mirela mud të kalosh në një tavolinë tjetër.

.....Zhurmë në sallë

Mirela Shala: Nuk e di a funksionon kjo. Shumë mirë. Ja. Ok.

Në fakt mezi e kam pritur këtë mbledhjen e parë të Këshillit Bashkiak për faktin se duke qenë se jam pjesë e arsimit dhe vij sot nga një problem madhor jam e detyruar të shpreh një shqetësim shumë të madh të cilin ne e ndajmë si staf të gjimnazit Gjerg Kastrioti, por jo vetëm edhe të komunitetit dhe nxënësve, të cilët i kemi çdo ditë duke i çuar atje ku kanë destinacionin dhe ëndërrat e tyre. Mirëpo kjo ëndërr më duket sikur ka filluar të zbehet paksa për shkak të disa kushteve që i tërë Durrësi e njeh, e njeh si problem domethënë. Nuk diskutohet që është viti i gjashtë ta përmendim. Duket o Zot sa e largët, sa e gjatë. Shumë e shumë breza po mbarojnë pa e njohur shkollën e tyre. Për ne është shumë problem jashtëzakonisht jo vetëm për ne si arsimtarë, por dhe për ata kur shprehen nëpër rrugët e qytetit të Durrësit duke e dhënë atë zhgënjimin e tyre

që nuk patën një shkollë, nuk dolën nga shkolla e tyre siç dolën fëmijët e mi e shumë fëmijë të tjerë. Pra është viti i pestë, ka mbetur i pezulluar për shkak të zbulimeve arkeologjike. Nuk jam kundra fare. Absolutisht. Unë jam pro ruajtjes së trashëgimisë kulturore. Për mua është shumë e rëndësishme gjithë ky zbulim i madh që është bërë në qytetin tonë është një arritje, nuk e di domethënë është goxha e rëndësishme, është relike, por kjo vonesë ka krijuar pasoja të drejtpërdrejta tek ne në arsim. Nxënësit janë të detyruar të ndjekin turnin e dytë për vitin e gjashtë dhe kjo ka bërë që cilësia e mësimnxënies, jo e mësimdhënies, sepse ne mësuesit mund të themi që jemi heronj. Ne punojmë, ne zgjohemi shumë herët, por punojmë dhe mbasditë deri në kohë shumë të zgjatura, derisa të vazhdojë procesi mësimor, por të përmbushim edhe shkolla qendër komunitare, pra edhe procese të tilla që i kemi tashmë prej vitesh. Mirëpo kjo ka ndikuar në mësimnxënien e tyre duke i lodhur ata dhe po dhe duke ndikuar negativisht tek prindërit. Kush është pasoja? Ky ishte shkak. Kush është pasoja? Pasoja ka një rënie të madhe të numrit të nxënësve një, dhe e dyta është dhe shkurtimi i stafit mësimor. Na vjen keq që kolegët tanë janë të detyruar të ikin dhe të mos jenë më pjesë e stafit mësimor. Sigurisht pyetja është vetëm kjo. Pra është e domosdoshme, nuk dua ta zgjas shumë fal, që institucionet përgjegjëse të gjejnë një zgjidhje të ndërmjetme në mënyrë që të ruhet edhe kjo trashëgimia kulturore, por njëkohësisht të mos cënohet e drejta e fëmijëve për një arsim cilësor dhe e drejta mësuesve për të ushtruar profesionin e tyre. Dhe pyetja, cilat janë masat konkrete që merr bashkia këtë vit të paktën se kemi dëgjuar herë pas here, ne jemi shumë të interesuar nonstop me këtë problem, se na shqetëson jashtëzakonisht shumë. Cilat janë masat që po merr bashkia për të përshpejtuar ndërtimin e gjimnazit Gjersh Kastrioti, i cili ka shumë vite? Faleminderit.

Denisa Luarasi: Je është shumë e qartë. Faleminderit dhe suksese.
Po, zonja Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë së pari ju uroj mirëseardhjen koleges. Është e re në këshill dhe ndoshta me procedurën cedon pak. Kryetare unë kisha një kërkesë që të respektohet procedura dhe fjalimi i mbajtur nga kolegja do të ishte me, do të ishte me vend që të bëjë në fund të të gjithë rendit të ditës, sepse pika për të cilën ne flasim ka të bëjë për miratimin e planit të arsimit parauniversitar. Dhe një diçka tjetër, unë e kuptoj shqetësimin për arsimin, ka dy gjëra që nuk shkojnë në fjalimin e zonjës. Së pari, ka të bëjë me merakun që kishte për cedimi në mësimnxënie dhe jo në mësimdhënie. Sqaroj një diçka kur një mësues apo arsimtar pranon këtë detyrë të rëndësishme, është i qartë për qëllimin që ka, është i qartë për kushtet e punës dhe është i qartë për misionin e tij. Kështu që në lidhje me merakun që keni për vështirësinë në mësimnxënie, nuk cedon as nga godina, nuk cedon as nga orari. Unë vetë personalisht fëmijët i kam në turnin e dytë, kështu që nuk kam pasur absolutisht probleme. Unë do të isha sot në vendin tuaj merakosur më shumë dhe ndoshta do shqetësohesha për projektin. A është një projekt i duhur? A është një godinë që do të ketë të gjitha kushtet. Kjo po.

Dhe një diçka tjetër, sërish kur vihet në këshill, ne si këshilltarë zhvishemi nga të qenurit qytetarë të thjeshtë dhe kur parashtrojmë shqetësimet që kanë qytetarët, nuk e kam të pamundur të vij dhe të shprehem sot tek ju, që me të dëgjuar e kam që është ky problem apo me të dëgjuar e kam, që është ky shqetësim. Ne flasim këtu me shqetësimin e qytetarëve me zë, me figurë, me prova, dhe patjetër që keni të drejtën tuaj të kërkonit stafit të bashkisë Durrës të jenë prezent në mbledhjet e komisioneve dhe të japin përgjigjet që ju kërkonit, sepse ndoshta që dëshironi është tjetër gjë.

Kështu që merakun im i vetëm kryetarë është në lidhje me procedurën që komentet që janë jashtë pikës së rendit të ditës të lihen në fund. Faleminderit

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj, nënkryetarë keni kërkuar fjalën.

Elio Jani: Përshëndetje të gjithëve.

Doja t'ju përgjigja këshilltares faktikisht për pjesën e pyetjes së fundit fare, se kometin nuk besoj t'i jap përgjigje komentit. Por meqënëse keni qenë shumë me merak të madh nuk po e gjëmoni te pjesë. Nuk e di domethënë keni kohë. Ne kemi komunikim të vazhdueshëm me drejtoreshën e shkollës. Nuk ka munguar asnjëherë komunikimi. Ne si bashki kemi komunikim zyrtar gjithmonë me drejtuesit me thënë të drejtën. Dhe besoj që drejtuesit jua transmeton ju, pjesë e komunikimit, por gjithsesi po ju informoj se edhe kryetarja ka bërë një njoftim para disa ditësh, por nuk keni qenë e vëmendshëm edhe kryeministri, atë e di që nuk e keni ndjek bashkia e Durrës në fazën finale të përfundimit të projektit të shkollës si do jetë edhe shkolla Gjergj Kastrioti e re e rindërtuar së bashku me gjetjen arkeologjike. Është një projekt ambicioz dhe është nga më të bukurit në Ballkan, jo vetëm në Shqipëri. Meqënëse po ja them këtu, transmetoni fjalën edhe te mësuesit e tjerë që kanë këtë merakun e madh, por te pjesa e mësimit siç e tha dhe Joniada, e cila është pedagoge, nuk besoj që është problem mësimmxënia te pjesa e godinës. Unë jam një moshë disi të madhe kur shkollat në vitet kur kam bërë unë shkollën nuk ka qenë kushtet që janë sot edhe shqyr zotit e kemi maru shkollën shumë mirë, domethënë kupton në qoftë se mësuesi jep mësim mirë, kam zyshën këtu përballë domethënë, apo jo. Kushte të mira për 92-in jo për 2025-ën këto. Faleminderit

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti nënkryetar.

Kalojmë votim.

Kush është pro pikës 3 të rendit të ditës?

Kundër? Abstenim?

Me 37 vota pro miratohet pa ndryshime dhe pika e 3 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin e **pikës 4** Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë kryetarë dhe në lidhje me pikën 4 ne si komision po prapë me shumicë votash e votuam dhe ftojme këshillin sot që të japi votën pro. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

E merr fjalën Komisioni i Buxhetit, Financave dhe Taksave - Tarifave, zoti Rolant Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Përshëndetje.

Urimet u bënë nga nënkryetarja, po kemi të drejtën të themi që shpresojmë që të kemi një sesion shumë të mirë bashkëpunimi për të mirën e qytetit. Nisja nuk është në atë nivel që duam, duhet, sepse pika 4 në komisionin e buxhetit kaloi vetëm me votat e anëtarëve të Këshillit të Partisë Socialiste. Janë dakord që t'i kaloj këshilli dhe të miratohet.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Xhelilaj.

Komente, pyetje kemi?

Po zoti Burgija.

Dritan Burgija: Kur keni hartu projektbuxhetin, çfarë strategjie ka bashkia për mbetjet? Po i bëj shpejt e shpejt 3 pika kam. Kam tre pyetje për tre zëra. E kam lexuar relacionin. Do doja të dija për mbetjet do vazhdojnë të shkojnë në Sharrë me kostot që kemi folur këtu domethënë, me mënyrën që është bërë deri tani apo do kenë do ketë një strategji tjetër për landfill çdo qytet apo ku di unë? Për furnizimin me ujë të pijshëm do bëhet agjenci kombëtare e ujit të pijshëm siç ka thënë kryeministri e ku di unë domethënë diçka e tillë apo do vazhdojë të jetë kështu. Nejse nga nga reagimi juaj nuk e di çfarë patët po dhe për shtimin dhe...

Denisa Luarasi: Duhet te kishit ardhur dhe ju në komision Burgija.

Pyetje duhet t'i kishit bërë në komision.

Dritan Burgija: Po dakort jam. Po ja ku jemi. T'i diskutojmë të gjithë bashkë. Në komision unë e shkruajta që e kam të pamundur dhe njerëz jemi dhe kemi dhe të pamundur herë mbas here. Dhe për strehimin social çfarë strategjie ka? Çfarë parashikon projektbuxheti?

Denisa Luarasi: Po. Faleminderit zoti Burgija.

Nënkryetar.

Elio Jani: Në lidhje me pyetjen tuaj. Pjesa e mbetjeve urbane është e njëjta procedure që kemi ndjekur deri tani. Atë po ndjekim. Për pjesën e ujit bëra atë reagim, sepse bashkia nuk ka funksion fare te pjesa e ujit. Po ndoshta ju nuk keni update me këtë pjesë ka vite aksioner po jemi në minorancë prandaj po të them dhe atë vendos qeveria me vendimet e saj. Ne jemi normalisht që duhet të zbatojmë vendimet qeveris te kjo pjesë.

Tek strehimi social bashkia e Durrësit ka një projekt ambicioz për vitin e ardhshëm ne presim që të shpërndajmë të gjithë apartamenteve të procesit të rindertimit dhe të gjithë ato apartamente që do ngelin bosh, bashkia e Durrësit vitin e ardhshëm do hapi aplikimin për banesë sociale me qera që jemi, besojmë që do të zbutë sadopak këtë problem që kemi ne në qytetin tonë.

Denisa Luarasi: Faleminderit nënkryetar.

Kalojmë në votim.

Kush është pro pikës 4 të rendit të ditës?

Kundër?

Abstenim?

Atëherë me 29 vota pro dhe 8 kundër miratohet pika 4 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 5** Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë kryetare pika 5 është në vazhdën e kujdesit që bashkia Durrës ka gjatë gjithë vitit dhe ne kemi marrë vendime të kësaj natyre në komision, kështu që dhe për pikën 5 komisioni ynë votoi pro dhe fton këshillin që të japi miratimin e tij. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

E merr fjalën komisioni i Barazisë Gjimore i Mirëqenies Sociale dhe Mosdiskriminim zonja Eda Shemsi.

Edlira Shemsi: Komisioni i Barazisë Gjimore i Mirëqenies Sociale dhe kundër Diskriminimit pasi mori në shqyrtim listën e individëve dhe familjeve që marrin ndihmë ekonomike për muajin gusht 2025 nga fondi limit 6% dhe nga të ardhurat vendore, janë 37 % nga fondi limit 6% dhe 134 familje nga të ardhurat vendore, i miratoj ato dhe ja paraqit këshillit për miratim.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Harizi.

Komente, pyetje ka?

Kush është pro?

Me 37 vota pro miratohet pa ndryshime dhe pika 5 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 6**, Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë edhe në lidhje me pikën gjashtë komisioni ynë po prapë me shumicë votash e votoi pro dhe fton këshillin të japi miratimin e tij. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

Komisioni i Buxhetit, Financave, Taksave e Tarifave zoti Rolant Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Edhe Komisioni i Buxhetit me shumicë të votës e kalon pikën 6 për miratim Këshillit Bashkiak.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Xhelilaj.

Komisioni i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit, zonja Blerina Reçi.

Blerina Reçi: Dhe komisioni ynë unanimisht e votoj pro.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Reçi.

Kemi komente, pyetje?

Kalojmë votim.

Kush është pro pikës 6 të rendit ditës?

Me 37 vota pro miratohet pa ndryshim edhe pika 6.

- Kalojmë te pika e shtatë. I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 7**, Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë pika 7 kryetare ka lidhje me një risi krijimin e një akademie për trajnimin e njësisë vetëqeverises vendore të Republikës së Shqipërisë. Kështu që komisioni ynë ra dakort e miratoi me shumë kënaqësi dhe kërkojmë nga Këshilli miratimin e tij. Shumë faleminderit.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit zonja Musaraj.

Kemi komente pyetje për pikën 7?

Kalojmë votim.

Kush është pro?

Pika 7 Reçi ?

Me 37 vota pro miratohet pa ndryshim edhe pika 7.

- I jepet fjala për projektvendimin **e pikës 8**, Komisionit Rregullores, Çështjeve Juridike zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë kryetare dhe në lidhje me pikën 8. Ne dhamë votën pro dhe kërkojmë nga Këshilli që të miratojë këtë pikë. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

Komisioni Strehimit Shërbimeve Publike, zonja Feshti.

Marsida Feshti: Përshëndetje kryetare. Përshëndetje kolegë.

Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike ka votuar me shumicë votash që të kalojë për votim në Këshill. Faleminderit.

Denisa Luarasi : Faleminderit zonja Feshti.

Komente pyetje ka për pikën 8?

Dritan Burgija: Po jemi shpreh kundër, atëherë.....

Denisa Luarasi: Të lutem. Po, po Burgija.

Dritan Burgija: Komentet i kemi bërë kur kemi miratuar, sot kemi ndryshime. Komentet i kemi bërë kur kemi miratuar, është miratuar atëherë kjo puna e parkimeve. Për të njëjtën arsye ne shprehemi kundër sot dhe votojmë kundër këtë pikë.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Burgija.

Atëherë kalojmë votim.

Kush është pro?

Kundër? Abstenim?

Me 25 vota pro dhe 11 kundër miratohet dhe pika 8 e rendit të ditës.

- Ka kërkuar fjalën **për diskutim** zonja Anisa Ibraj.

Anisa Ibraj: Përshëndetje të gjithëve!

Si fillim dua t'ju uroj shumë suksese të gjithë nxënësve, mësuesve për këtë vit të ri akademik në qytetin e Durrësit dhe gjithë Shqipërisë patjetër. Tani me kërkesë të prindërve, të nxënësve të shkollës “Met Hasa”, duam të dimë përse është ndërprerë pagesa e transportit të tyre kur ndërkohë shkolla është në rindërtim. Familjet, fëmijët janë në një shkollë 9 vjeçare, pra praktikisht i bie që janë nga klasa e parë deri në klasën e nëntë dhe kanë një moshë të vogël për të ikur vetë me linjën urbane të zonës. Prindërit janë të shqetësuar sepse nuk kanë mundësi t'i dërgojnë vetë në shkollë

pasi janë në punë. Gjithashtu është kosto ekstra për ta. Shpresojmë shumë që të konsiderohet dhe njëherë pagesa e transportit pasi është detyrim për ne siguria e tyre. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Ibraj.

Elio Jani: Po zonja Ibraj unë e lexova atë pyetjen tuaj faktikisht, por doja t'ju informoja ju dhe gjithë këshilltarët e tjerë që transporti, pagesa e transportit nuk është në funksionet që kryhet bashkia e Durrësit. Unë pata një komunikim sot në sajë të problematikës tuaj me drejtoreshën e arsimit të Durrësit dhe ma shpjegoi problematikën që kishte shkolla “Met Hasa”. Ajo kishte bërë një takim dje në ministri dhe besoj tha problematika do të zgjidhet shumë shpejt, por theksoj nuk është në kompetencën e bashkisë së Durrësit. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit nënkryetar.

Duke ju falenderuar për prezencën mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Mirutakofshim mbledhjen tjetër.

Ky proçesverbal mbyllet me nr. rendor 14 (katërmëdhjetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga drejtuesi i seancës, sekretari i këshillit dhe 3(tre) këshilltarë.

Mbajtësi i proçesverbalit: Enxhi Gjuzi

Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :

Drejtues i seancës (Zv/kryetar i Këshillit Bashkiak) : DENISA LUARASI

Sekretar i Këshillit Bashkiak : DORINA MILJA

Këshilltar (Zv/kryetar i Këshillit Bashkiak) : EDLIRA DEVOLLI

Këshilltar (Kr. Grupi) : FLORIAN TAHIRI

Këshilltar (Kr. Grupi) : FLUTURA KASA